



**ALBSIG
INVEST**

Nr. 286 Prot.:

Tiranë, më 24/12/2021

Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", nr.33, Tiranë

Lënda: Mbi regjistrimin e ndryshimeve në Statutin e shoqërisë "Albsig Invest sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve".

Të nderuar,


Në vendimin nr. 04, datë 23.12.2021, Aksionari i Vetëm ka vendosur zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Albsig Invest sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve", me burim nga aksionari i vetëm, ndryshimin e nenit 5, pika 1 si dhe disa ndryshime të tjera të Statutit të Shoqërisë.

Duke Ju falënderuar paraprakisht, luteni të pasqyroni ndryshimet e mësipërme.

Bashkëlidhur do të gjeni vendimin e sipërcituar.

AKSIONARI I VETËM

SHOQËRIA ALBSIG JETË SH.A


Z. Ervin SPAHIU

Përfaqësues i aksionarit të vetëm.





V E N D I M

Nr. 04, datë 23/12/2021

PËR ZMADHIMIN E KAPITALIT DHE DISA NDRYSHIME NË STATUTIN E SHOQËRISË "ALBSIG INVEST" SH.A

Në mbështetje të neneve 5 dhe 9, të Statutit të Shoqërisë "Albsig Invest sh.a - Shoqëri Administruese e fondeve të pensionit dhe e sipërmarrjeve të investimeve kolektive", Aksionari i Vetëm,

V E N D O S I:

1. Zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Albsig Invest" sh.a në shumën 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milion) lekë, me burim nga aksionari i vetëm.

2. Në Statutin e Shoqërisë, neni 5, pika 1 e statutit të Shoqërisë ndryshohet si më poshtë:

"Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

5.1 Kapitali i nënshkruar dhe tërësisht i paguar i Shoqërisë është 69 000 000 (gjashtëdhjetë e nëntë milion) lekë i cili përbëhet nga 69 000 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë) aksione të zakonshme me një vlerë nominale prej 1 000 (një mijë) lekë secili. Kapitali është nënshkruar dhe paguar si më poshtë:

5.1.1 Shoqëria "Albsig Jetë" sh.a, zotëron 69 000 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë) aksione të cilat përbëjnë 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë."

3. Në mbështetje të Ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe Rregullores të AMF nr. 112/2020 "Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë" miratohen ndryshimet në statutin e shoqërisë si më poshtë:

- a) Në statutin e Shoqërisë kudo ku është përdorur togfjalëshi "Albsig Invest sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive" zëvendësohet me togfjalëshin "Albsig Invest sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve".
- b) Në nenin 4, pika 4.1.2. ndryshohet si vijon: "4.1.2. Themelimi dhe/ose administrimi i sipërmarrjeve të investimeve kolektive sipas ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe aktet nënligjore/rregullatore".
- c) Në nenin 12, pika 12.3.12 ndryshohet si vijon: "12.3.12. të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligjin nr.9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; në ligjin nr.10197/2009 "Për fondet e pensionit vullnetar"; në ligjin nr.56/2020: "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe në ligjin nr. 62/2020 "Për tregjet e kapitalit", akteve nënligjore dhe rregullatore në zbatim të ligjeve të mësipërme si dhe në Statut."
- d) Në nenin 12, pas pikës 12.3.12 shtohet pika 12.3.13 me këtë përmbajtje: "12.3.13. Miraton aktet e brendshme rregullatore të Shoqërisë".
- e) Në nenin 13, pika 13.2. ndryshohet si vijon: "13.2. Administratori duhet të plotësojë kërkesat e ligjit nr. 9901/2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; ligjit nr. 10197/2009, "Për fondet





ALBSIG INVEST

e pensionit vullnetar", ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe aktet rregullatore të organit mbikëqyrës (Autoritetit-AMF)."

- f) Në nenin 13, pika 13.3.8 ndryshohet si vijon: "13.3.8 Të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligjin nr.9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"; ligjin nr.10197/2009 "Për fondet e pensionit vullnetar"; ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" si dhe ato të deleguara nga Këshilli i Administrimit."
- g) Në nenin 17, pika 17.1.6 ndryshohet si vijon: "17.1.6 çdo përcaktim që parashikohet në ligjin nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar"; ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi."
- h) Në nenin 14 pika 14.2., pas fjalës shoqëria shtohet togfjalëshi: "administruese të fondit/fondeve të pensionit; sipërmarrjeve të investimeve kolektive".


4. Të miratohet teksti i konsoliduar i Statutit të shoqërisë "Albsig Invest sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve", sipas tekstit bashkëlidhur.

5. Ngarkohet Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi dhe kryerje e veprimeve sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AKSIONARI I VETËM

SHOQËRIA ALBSIG JETË SH.A


Z. ERVIN SPAHIU

Përfaqësues i aksionarit të vetëm.

